

APD: LOCATIONS, projekti mbledh grupet e interesit në portin e Durrësit

10 tetor 2018



Partnerët dhe grupet e interesit që përfitojnë nga projekti LOCATIONS –Loë Carbon Transport in Cruise Destinations Cities- ku APD është partner, zhvilluan sot në Durrës takimin e përbashkët me qëllim përmirsimin e logjistikës në lidhje me lundrimin dhe planifikimin e transportit. Ky takim ka si qëllim prezantimin e LCTP te palët e interesit, duke synuar implementimi e tij në qytetin e Durrësit.

Tashmë sipas organizatorëve është realizuar “Plani për uljen e karbonit në transport - LCTP) për qytetin e Durrësit. Hartimi i planit të zhvillimit për Durrësin, si një qytet me destinacion kroçerash do të mundësojë masat për një transport me sasi të ulët karboni dhe krijimin e lidhjeve multimodale për ta lehtësuar sa më shumë atë.

Bashkë me përfaqësuesit e APD, të Institutit të Transporteve dhe Bashkisë Durrës, si partnerë të projektit, në takimin e sotëm marrën pjesë edhe përfaqësues nga Universiteti “Aleksandër Moisiu”.

Përgatitja dhe implementimi i projektit LOCATIONS ka nisur në vitin 2016, ndërsa projekti do të përfundojë në 2020. Partnerët e këtij projekti 4-vjeçar janë edhe portet e qytetet e Lisbonës, Malagës, Zadarit, Rijekës, Ravenës dhe Triestes.

